



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KAVAJË

Nr. \_\_\_\_\_ prot.  
2020

Datë \_\_\_\_\_ / \_\_\_\_\_ /

## NJOFTIMI I KONTRATËS

### 1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri Bashkia Kavajë  
Adresa Bulevardi "Josif Budo"  
Tel/Fax 055 24 800 808  
Personi përgjegjës: Eduart Aliu  
Tel: +355 67 68 77 888  
E-mail: [eduart.aliu@bashkiakavaje.gov.al](mailto:eduart.aliu@bashkiakavaje.gov.al)  
Faqja e Internetit [bashkiakavaje.gov.al](http://bashkiakavaje.gov.al)

### 2. Lloji i procedurës së prokurimit: PROCEDURË E HAPUR MBI KUFIRIN E LARTË MONETAR

### 3. Objekti i kontratës: SHËRBIMI I PASTRIMIT TË NJËSISË ADMINISTRATIVE GOLEM

### 4. Numri i referencës së procedurës/lotit REF-52946-03-04-2020

### 5. Fondi limit: 255,581,960 lekë pa tvsh

(dyqind e pesëdhjetë e pesë milion e pesëqind e tetëdhjetë e një mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë)

### 6. Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: 5 vjet

Bazuar në nenin 76 pika 3 të Vendimit Nr.914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", (e ndryshuar). Burimi i financimit për këtë shërbim është i parashikuar nga Të ardhurat e Bashkisë Kavajë, të cilat gjenerohen nga tarifa familjare e pastrimit dhe tarifat e pastrimit për bizneset që ushtrojnë veprimtari tregtare. Ky fakt e bën financimin dhe likuidimin e këtij shërbimi të garantuar ndërvite. Gjithashtu, financimi i shërbimit të pastrimit është pjesë e buxhetit afatmesëm dhe afatgjatë të hartuar nga Bashkia Kavajë, duke i dhënë prioritet të vecantë.

Interesi publik është primar dhe është detyrë e Bashkisë Kavajë që kjo gjë të mos cenohet. Kërkesat e autoritetit kontraktor Bashkia Kavajë, janë realizimi i vazhdueshëm, eficient dhe me cilësi shërbimit të pastrimit. Për këtë arsye, kërkesa e Bashkisë Kavajë është që shërbimi i pastrimit të kryhet me mjete teknologjike bashkohore, me staf të specializuar dhe eficient. Të gjitha këto kërkesa përthihen në shërbime cilësore dhe mjedis sa më të pastër. Por në të njëjtën kohë janë barre për operatorët ekonomikë të cilët janë të detyruar të investojnë me kosto më të larta se vlera vjetore e shërbimit që kërkohej prej Autoritetit Kontraktor. Kontratat shumëvjeçare krijojnë një raport më të mirë ndërmjet kërkesës së Autoritetit Kontraktor për shërbime cilësore dhe kostos që kanë operatorët ekonomikë për të ofruar këto shërbime me kapacitete optimale.

Duke marrë gjithashtu në konsideratë përvojën e mëparshme të prokurimit të kontratave të

kesaj natyre dhe faktin qe procedurat e prokurimit te sherbimit te pastrimit I kapercejne afatet e parashikimit te Autoritetit Kontraktor per realizimin e tyre ne kohe, gje e cila do te sillte si pasoje mungesen e sherbimit te pastrimit, gjykojme qe kontratat 5-vjecare jane te domosdoshme.

- 7. Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: 20.04.2020 ora 10:00**
- 8. Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: 20.04.2020 ora 10:00**

Kryetari  
**Redjan KRALI**